

NERMIN BASHA

**EPIRI DHE BOTA ILIRE NË VEPRËN E JUL CEZARIT,
“MBI LUFTËN CIVILE”**

Në gjysmën e dytë të shek. I para e.s. trualli ilir, i rënë tashmë nën zgjedhën romake në pjesën më të madhe të tij, u trondit sërish nga këmba e ushtarit pushtues, nga Lezha e lashtë deri në Butrint; këtë herë toka ilire, veçanërisht pjesa bregdetare, u bë shesh lufte midis dy kryegjeneralëve romakë, Pompeut dhe Cezarit, që përfaqësonin fuqinë më të madhe ushtarake e politike atë çast në Romë. Fillimisht, ata qenë miq, shokë idesh dhe bashkëpunëtorë të ngushtë, por, me kalimin e kohës dhe me vrasjen e Krasit, lindën mosmarrëveshje e grindje, që çuan në luftën e armatosur, e cila njihet në histori si “Lufta Civile”. Në përplasjen mes tij dhe Pompeut, Cezari mbajti shënime, të cilat, më pas, i paraqiti në një vepër, “De bello civili”, mbërritur deri në ditët tona. Edhe autorë të tjerë pas tij kanë shkruar për këtë ngjarje, duke plotësuar kështu ato që nuk i ka thënë Cezari, por asgjë nuk kemi nga Pompeu. Vepra e Cezarit, “Mbi luftën civile”, që, prej 3-4 vitesh ndodhet edhe në dorë të lexuesit shqiptar, pasqyron përmbledhjen e grindjes së armatosur mes tij dhe Pompeut.

Shkrimet e Cezarit ndahen në tre libra. Si nuk arriti të siguronte asgjë përmes bisedimeve, të kërkuara me ngulm prej tij, Cezari iu drejtua armëve dhe ushtrisë, për të zgjidhur situatën në të cilën e futi Senati Romak dhe Pompeu. Nga Galia, ku ndodhej atë kohë, Cezari hyri me ushtri në atdheun e vet, Itali, kurse Pompeu dhe Senati ia mbathën në Brindizi, që andej u hodhën në Selanik e, pastaj, në Durrës, ku Pompeu grumbulloi tërë arsenalin e luftës dhe nozullimet e nevojshme. Cezari i ndoqi, por nuk i kapi dot në Brindizi, sepse ata e kaluan detin, prandaj, për mungesë mjetesh, i la të iknin. Si siguroi krahët, duke thyer në Spanjë, në Afrikën Veriore dhe në Marsejë e gjetiu forca të shumta pompejane, dhe si porositi ndërtimin e anijeve, Cezari u kthye në Romë për të organizuar zgjedhjet, ku fitoi dhe u zgjodh konsull; me këtë ngjarje nis rrëfimi i tij në librin e tretë, që përbëhet nga 112 krrerë. Qëndroi në Romë për të kryer ca punë, pastaj, me shpejtësi marramendëse, marshoi kundër Pompeut, në zemër të dimrit kapërceu Adriatikun dhe zbarkoi në

bregdetin epirot. Nga ky çast, interesi i shkrimit cezarian në lidhje me shkencën e ilirologjisë, në veçanti, dhe atë albanologjike në përgjithësi, rritet, sepse Cezari, sado i kursyer në përmendje të emrave të vendeve, qyteteve, krahinave, lumenjve, fiseve etj., prapëseprapë na ka dhënë lëndë të vlefshme për historinë e qëmoçme të trojeve tona.

Duke i shpëtuar përgjimit dhe ruajtjes së flotës pompejane, vendosur në Korfuz, Cezari i zbriti trupat e vet në bregdetin epirot, në një zonë shkëmbore dhe të vështirë, në Palasë të Himarës; pastaj, me nxitim, pushtoi portin e Orikumit, të Apolonisë dhe kërcënonte Durrësin, ku u zhvilluan dy beteja, por pa e marrë dot. Pas kësaj ngjarjeje, Cezari zuri vend mes Durrësit e Apolonisë. Dy kundërshtarët e bënë vendin tonë teatër të veprimeve të tyre; malet Akrokeraune, sot Malet e Vetëtimës, rruga e Kandavisë, lumenjtë Vjosa, Semani, Shkumbini, lumenjtë e vegjël Darçi, Leshniqe, porti i Orikumit, i Durrësit, i Shëngjinit, qytetet, si : Durrësi, Lezha, Apolonia, Butrinti, Bylis, Amantia, fusha e Kavajës, fiset dalmate, liburne, dardane, parthine, përdorimi i bimës këlkazë për të gatuar bukë e mjaft të tjera, vijën të emërtuara drejtpërsëdrejti ose të nënkuptuara në librin e tretë të Cezarit.

Prandaj, në këndvështrimin tonë, libri III i veprës së Cezarit është parë nga ndihmesa që mund të japë në plotësimin e lëndës së historisë së lashtë të Shqipërisë ose herë-herë si dokument shtesë.

Në 67 nga 112 krerët e librit të tretë të “Luftës civile” ne gjejmë të njoftuara drejtpërsëdrejti ose të nënkuptuara emra qytetesh, vendesh, fisesh, malesh, lumenjsh të trojeve të vendit tonë në kohën e zhvillimit të ngjarjeve dhe, mes paraqitjes tepër të shkurtër nga autori, mund të mësojmë për qëndrimin e popullsisë ndaj komandantëve romakë, për gjendjen e rrugëve dhe të komunikacionit, në përgjithësi, për gjendjen e fushave dhe prodhimtarinë e tyre, për dendurinë e popullsisë, për bimësinë e vendit, për blegtorinë e mjaft njoftime të tjera.

Në këtë paraqitje të shkurtër, ne do të ndalemi më shumë në përmendjen e emrit të Epirit e të qyteteve të ndodhura në të ose pranë tij, nga Cezari dhe nga autorë të tjerë para e pas tij. Ai e ka përmendur 8 herë emrin *Epir* gjatë librit të tretë, respektivisht në krerët: 4, 12, 13, 42, 47, 61, 78 dhe 80, por jo vetëm, sepse në disa krerë të tjerë emrat e vendeve a qyteteve, nënkuptojnë zonën e Epirit.

Pjesa e mëposhtme është vetëm një cekje e vogël e disa përmendjeve të Cezarit, e komentuar dhe e plotësuar me material autorësh të tjerë, para e pas autorit të veprës në fjalë.

Kreu 4 - ...Përveç këtyre, duke dashur të plotësonte numrin e trupave, kishte shpërndarë nëpër legjione shumë ushtarë nga Tesalia, Beotia, Akaia dhe Epiri...¹

Në kreun IV të librit të tretë, Cezari tregon për forcat e Pompeut, duke nisur me 9 legjionet e formuar nga qytetarë romakë, pesë nga të cilët i kishte marrë nga Italia. Por këtyre forcave ai u kishte shtuar edhe ushtarë nga zonat e tjera të pushtuara. Jemi në vitin 48 para e.s. dhe pjesa më e madhe e trojeve ilire ishte nën sundimin romak, pra, i konsideronin troje të vetat dhe shfrytëzonin si pasuritë e tokës e të nëntokës, ashtu edhe rekrutimin e burrave e të djemve për ushtritë e tyre. Për fushatën e tij, Cezarit nuk i interesonte ku fillonte e ku mbaronte Epiri, por autorë të tjerë, para e pas tij, na kanë lënë dëshmi të qarta për shtrirjen e këtyre trojeve me popullsi epirote prej fisesh ilire.

Emri Epir e ka burimin te fjala greke *épeiros*² “tokë”, në kundërvënje me ishullin ose ishujt përballë, e përdorur nga popullsitë e tyre për të dalluar pjesën kontinentale. Ndoshta, edhe te fjala (i) *epërm* që do të thotë i lartë, meqë kjo është zonë malore, kështu mundet që popullsitë e ishujve, nëse s’kanë qenë ilirë, ta kenë marrë nga paraardhësit tanë. Ky emër, që në fillim u përdor si emër i përgjithshëm për të caktuar pozitën kontinentale të krahinës etnikisht ilire, që ndodhej përballë tyre, më vonë u shndërrua në një nocion të përveçëm gjeografik, që i atribuohet një krahine të veçantë me kufij pak a shumë të përcaktuar historikisht. Me këtë kuptim, emri *Epir* ndeshet për herë të parë te shkrimtari grek i fundit të shek. VI para e.s., Hekateu, kur thotë se

¹ ...*Praeterea magnum numerum ex Thessalia, Boeotia, Achaia, Epiroque supplementi nomine in legiones distribuerat...* Cesare, *De bello civili*, liber tertius, Carlo Signorelli, Milano: 1938, f. 24.

² Edhe në: Pauly-Wissova, *Real Encyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Stuttgart: 1905, f. 2718, thuhet se Epeiros, d.m.th. “stere” dhe se kështu e quanin banorët e ishujve perëndimorë kontinentin e Greqisë së Veriut dhe Qendrore. Gjithnjë e më shumë, ky përcaktim u kthye në një emër të përveçëm të vendeve mes maleve Akrokeraune, në veri, dhe Gjirit të Ambrakisë, në jug, detit Jon, në perëndim dhe Thesalisë, në lindje. Po kështu, në *Historinë e Popullit Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, vëll. I, kreu IV, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 87, thuhet se në periudhën antike, treva që nga malet e Llogarasë dhe të Kudhësit me rrjedhën e mesme të Vjosës në veri, deri në Gjirin e Ambrakisë dhe në kufijtë e Etolisë në jug, që nga malet e Pindit në lindje e deri te brigjet e detit Jon në perëndim, përbënte një njësi gjeografike-politike më vete të formuar historikisht dhe të njohur me emrin Epir.

Orikumi është liman i Epirit, dhe pak më vonë te Pindari, i cili e quan Epirin “të famshëm me hapësira kodrash të shkëlqyeshme që fillojnë nga Dodona e deri në brigjet e Jonit”.³ Ky term është përdorur edhe nga Tukididi, që jetoi në shek. V. “Por, sipas Shaban Demirajt, ne nuk dimë se si e quanin veten dhe vendin e tyre në lashtësi banorët e të ashtuquajturit *Epir*. Në histori flitet për një Lidhje të Epirotëve, por ky emërtim, pas gjithë gjasash, i detyrohet ndikimit të kulturës dhe të gjuhës greke mbi drejtuesit politikë të kohës dhe nuk mund të merret si një dëshmi që banorët jogrekë të kësaj treve atëherë (ose edhe më vonë) ta kenë quajtur veten epirotë. Në kohët e njohura historike banorët shqipfolës të kësaj treve e quajnë veten, sipas viseve të tyre, përkatësisht çamë, labë a arbëreshë dhe toskë, kurse viset përkatëse ata i quajnë Çamëri, Labëri a Toskëri. Nuk ka asnjë dëshmi që emërtimet *Epir* dhe *epirot* të jenë përdorur nga banorët shqipfolës të këtyre viseve në marrëdhëniet e tyre të përditshme”.⁴ Po ky studiues më poshtë thotë se : “sipas Hammond-it thuhet se emri i mëparshëm i Epirit ka qenë *Aesa*, por ky autor nuk e jep burimin e këtij njoftimi dhe nuk sqaron më tej se sa dhe deri kur është përdorur ky emërtim”.⁵

Emri *Epir*, që nga lashtësia është përdorur për të emërtuar atë trevë, që në kuptim të ngushtë shtrihej nga Saranda deri në Gjirin e Artës (Ambrakia), kurse në kuptim më të gjerë, nga veriu, shkonte deri te Malet Akrokeraune (Malet e Vetëtimës). Në lindje, kufirin e asaj treve me Maqedoninë dhe Tesalinë, e shënonin malet e Pindit. Që nga lashtësia e kohërave, Efori, më parë, dhe Straboni, më pas, shkruajnë se, fillimi i Heladës, nga ana e perëndimit, është Akarnania, sepse kjo takon e para me fiset epirote.⁶ Po Straboni, në një paragraf tjetër, shprehet se më

³ *Historia e Popullit ...*, f. 87.

⁴ Shaban Demiraj, *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*, kreu 2, Tiranë: INFOBOTUES, 2008, f. 54.

⁵ *Po aty*, f. 55.

⁶ Strabonis, “*Geographica*”, libri VIII, kreu I, paragrafi 3 (“*Εφορος μὲν οὖν ἀρχὴν εἶναι τῆς Ἑλλάδος τὴν Ἀκαρνανίαν φησὶν ἀπὸ τῶν ἐσπερίων μερῶν. Ταύτην γὰρ συνάπτειν πρῶτην τοῖς Ἠπειρωτικοῖς ἔθνεσιν*). Në lashtësi Epiri ka përfaqësuar një entitet të dallueshëm qartë nga Greqia, e pohuar kjo nga vetë autorët antikë grekë dhe latinë e duke ardhur deri në ditët tona, deri nga viti 1840. Kështu, Efori (400 para e.s. – 330 pra e.s.), Pseudo-Scylaksi (shekulli VI –V para e.s.), Straboni (63 para e.s – 20 e.s.) etj. e shihnin këtë çështje po ashtu si Tukididi, që jetoi nga viti 460 para e.s deri më 395 para e.s. Pseudo-Skylaksi, në “*Periplus*”, 20.27;

poshtë vjen gryka e Gjirit të Ambrakisë; gryka e këtij gjiri është pak më e madhe se katër stade, ndërsa rrethi i tij arrin në treqind stade dhe i gjithi ka limane të mira. Kur lundron në të djathtë banojnë akarnanët, fis helen. ... Nga ana e majtë ndodhet Nikopoli dhe kasiopët, një fis epirotësh, që shtrihen gjer në gjirin e Ambrakisë⁷, duke na dëshmuar se caku më jugor i Epirit ishte bregu i sipërm i Gjirit të Ambrakisë. Në Epir banonin epirotët. Tukididi bënte dallim të qartë midis grekëve dhe epirotëve fqinjë, kur përmendte kaonët dhe fqinjët e tjerë barbarë, si edhe njëmijë “barbarët”: kaonët, tesprotët.⁸ Mes autorëve të lashtësisë që flasin e tregojnë për Epirin, mund të përmendim edhe autorë romakë, si Plinin, i cili në veprën e tij “Historia e natyrës” e përshkruan kështu: “I marrë në

28.32, thotë se “pas Molosisë vjen Ambrakia, qytet helen. Këtu fillon Helada, pa ndërprerje deri te lumi Peneus”. Të njëjtën gjë shumë më vonë, pohon Glotz, “*Histoire ancienne*”, “*Histoire Grecque*”, Paris: 1938, f. 7; Selim Islami në “Epiri antik” (vështrim i shkurtër etnologjik), në *Historia e Ilirëve*, përmbledhje punimesh, Albanian Heritage, Tiranë: “Toena”, f.139. Madje, kështu ka vazhduar pa ndërprerje edhe në Mesjetë, d.m.th. kufijtë e Greqisë ishin të qartë, pohuar nga Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, studime mbi Shqipërinë mesjetare, Tiranë: “Pegi”, 2006, f. 427-428, i cili përmend shkrimin e Pahimerit të shek. XIII: “Greqia e vërtetë shtrihet këndeje Pindit”, i ndjekur nga bashkëkohësi i tij, historiani bizantin Akropolit. Matanë Pindit fillonte zona e “barbarofonëve”, saktësonte peshkopi i Grebenesë, Georgios Bardhanes, i cili shtonte se qyteti i Vonicës, në bregun jugor të Ambrakisë, ishte qyteti i parë ku udhëtari që zbriste nga veriu dëgjonte të flitej gjuha greke. Akoma më eksplicit, vazhdon Xhufi, është një autor i fillimit të shek. XV: “Epiri banohej në kohët e vjetra nga **fise ilire**, që kishin burra të shumtë e trima... Edhe tani ai vend banohej nga shqiptarët, fis ilir”. Këto pohime vërtetohen më tej edhe nga regjistra osmanë të popullsisë së Epirit, hartuar në shek. XVI e XVII e nga mjaft dokumente të tjera. Të njëjtën gjë shohim edhe në komentin e historianit gjerman, J.Ph.Fallmerayer, aty nga mesi i shek. XIX: “Ndërkohë që vetë nuk japin e nuk bëjnë asgjë, grekët dëshirojnë gjithnjë vetëm të rrëmbejnë dhe praktikisht prej tridhjetë vjetësh nuk pushojnë së ankuari e së kërkuari para, ndere, privilegje e territore... Grekët pretendojnë se ata nuk do të mund të bëjnë asnjë përparim në jetën politike dhe se vendi do të vazhdojë të jetë i mbuluar nga bandat e grabitësve, përderisa atyre nuk do t’u jepet edhe Epiri e Tesalia...”.

⁷ Strabonis, “*Geographica*”, në *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, libri VII, kreu 6, Tiranë: “Oriko”, 1965, f. 159.

⁸ Thucydides, *Historiae*, libri II, kreu 80, (*...βάρβαροι δὲ Χάονες χίλιοι ἀβασίλευτοι ... εὐνεσπράτευοντο δὲ μετὰ Χαόνων καὶ Θεσπρωτοὶ ἀβασίλευτοι - ...* nga barbarët (ishin) një mijë Kaonë, që qeverisen pa mbretër... Merrnin pjesë në ekspeditë bashkë me kaonët edhe tesprotët, që, po ashtu, qeverisen pa mbretër).

përgjithësi, *Epiri* fillon prej maleve Keraune. Në të përfshihen në fillim Kaonët, prej të cilëve vjen emri Kaoni, Thesprotët, Antigonasit, vendi i quajtur Aorn ..., Kestrinët, Perrebejt, tek të cilët është mali i Pindit, Kasiopët, Dryopët, Selët, Helopët, Molosët, pranë të cilëve ndodhet faltorja e Dodonës së Jupiterit, e famshme për orakullin, mali Talar, me njëqind burimet në këmbët e tij, i lavdëruar nga Teopompi”.⁹ Përsëri Plini, pasi përmend edhe kështjellën e Himarës në malet Akrokeraune, nën të cilën ndodhet burimi me Ujin Mbretëror, si përmend qytetet Meandria, Kestria, lumin Thiamis të Tesprotisë, gjirin e Amrakisë dhe fushën e gjerë pranë saj, liqenin Akerusia, na tregon gjithashtu se “në gjë ndodhet qyteti i Ambrakisë; lumenjtë e Molosëve, Afa dhe Arathi, qyteti Anaktor dhe vendi i quajtur Pandosi”.¹⁰ Madje tek Apiani kemi pohimin se “grekët quajnë ilirë nga kaonët e tesprotët...”.¹¹ Kufijtë e Epirit ndaheshin me Ilirinë në veri, Tesalinë në lindje, Etoleinë në jug... Cilësoheshin si epirotë një numër i madh i fiseve ilire, të cilët në kohën e lulëzimit të Greqisë konsideroheshin si barbarë dhe, për rrjedhojë, Epiri nuk llogaritej si pjesë e Greqisë.¹² Të vjetrit quanin pjesë të Epirit gjithë luginën e Vjosës. Në lindje qëndrojnë malet e papërshkueshme të Pindit, të cilët e ndajnë Epirin nga Tesalia; si kufi mes Epirit dhe zonës së Pindit shërben lumi Arachtos, që rrjedh nga veriu në jugë. Por autorët e vjetër quanin si epirotë shumicën e popullsisë malësore të Pindit. Në krahun verior të Pindit, Epiri shtrihej deri në fushat e Tesalisë.¹³

⁹ C. Plinii Secundi, *Natyrallis Historiae*, libri IV, kreu 2 (*Epiros in universam appellata a Ceraunis incipit montibus. In ea primi Chaones, a quibus Chaonia, dein Thesproti, Antigonenses, locus Aornos ... Cestrini, Perrhaebi, quorum mons Pindus, Cassopaei, Dryopes, Selloe, Hellopes, Molossi, apud quos Dodonaei Jovis templum oraculo inlustre, Talarus mons, centum fontibus circa radices Theopompo celebratus*).

¹⁰ C. Plinii Secundi, *Natyrallis ...*, libri IV, kreu 4 (*...In sinu oppidum Ambracia. Molossorum flumina Aphas, Aratthus, civitas Anactorica, locus Pandosia*).

¹¹ Edhe Appiano Alessandrino në veprën e tij *Delle guerre civili de Romani*, në librin ku flet për luftërat e romakëve me ilirët, të titulluar “Delle guerre che i Romani fecero ne la Illiria”, In Venetia, Appresso Camillo Franceschini, 1575, f. 4, shkruan se grekët quajnë *Ilirë* të gjithë ata popuj që banojnë mbi Maqedoni dhe Trakë, nga kaonët dhe tesprotët deri në lumin Danub...

¹² Pauly-Wissova, *Real Encyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Stuttgart: 1905, f. 2718.

¹³ *Po aty*.

Më 1854 Hahni, ati i albanistikës, tezën e tij rreth burimit ilir të shqiptarëve e të shqipes e zgjeroi me anën e një vështrimi edhe të situatës etnografike të Ballkanit të vjetër. Në kryeveprën e tij, ai formuloi këto teza : 1 - Epirotët dhe Maqedonët edhe në kohë të Strabonit ishin jogrekë, ose barbarë; 2 - Epirotët, Maqedonët dhe Ilirët janë farefis në mes tyre, etj. Teza e afërisë së Epirotëve, Maqedonëve dhe Ilirëve në mes tyre është sot një mendim i pranuar pothuajse gjithkund, sepse ato të paka dëshmi që kanë mbetur nga gjuhët e këtyre popujve, flasin qartë për një të tillë afëri,¹⁴ pohim që, në formë tjetër, e gjejmë që herët përsëri te Straboni, që thotë se si tek maqedonët, edhe te tesprotët e molosët plakat i quanin *pelii* dhe pleqtë *pelii*.¹⁵

Një tjetër studiues, Ange Masci, esenë e të cilit gjeografi frëng, Malte-Brun¹⁶ e ka përfshirë në veprën e tij të famshme “Annales de Voyages” III (1809), thotë se *Epiri*, që ruan ende emrin e vet primitiv, fillon në malet Akrokeraune dhe mbaron në brigjet e Artës, që, në fillim, qe quajtur Ambrakia. Gjithë kjo shtrirje toke është e zënë nga albanët, që ndryshojnë prej grekëve dhe prej sllavëve, po aq sa edhe prej turqve, nga gjuha dhe nga zakonet.¹⁷ Po Hahni ka përçuar të njëjtën ide, duke na thënë se kufiri detar i Epirit shkon prej majës verilindore të Karaburunit deri te skaji verilindor i gjirit të Ambrakisë, ku, sipas përshkrimit të Skylaksit, fillon Helada.¹⁸

¹⁴ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëll. III, Prishtinë: “Rilindja”, 1976, f. 43.

¹⁵ Strabonis, “Geographica”, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ...*, libri VII, kreu 11, f. 161.

¹⁶ E. Çabej, *Studime ...*, f. 26.

¹⁷ Ange Masci, “Essai: Sur l’Origine, les Moeurs et l’Etat actuel de la Nation Albanaise”, në *Annales des voyages de la Geographie et de l’Histoire ou collection Des voyages nouveaux les plus estimés, traduits de toutes les Langues Européennes Des relations originales, inédites, communiquées par des voyageurs français et étrangers*. Publiées par M. Malte-Brun. Tome troisième, Paris: 1808, f. 147.

¹⁸ Johan Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854, Studime Shqiptare, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë: 2007, f. 24.

Mendojmë se është me vend të paraqesim këtu edhe mendimin e francezit Gustav Glotz, në lidhje me Greqinë, paraqitur në veprën e tij, *Histoire Ancienne. Histoire Grecque*, vëll. I, Paris 1938, f. 7, ku thotë: “Greqia e mirëfilltë nuk është veçse një pjesë , as më e pasura dhe as më e madhja e tokave që u bënë greke...Në të vërtetë, të vjetrit nuk kanë qenë aspak dakort për kufijtë e saj. Ata përfshinin këtu Tesalinë, për të përjashtuar, zakonisht, Epirin dhe gjithmonë Maqedoninë. Greqia

Edhe Jul Cezari e ka përdorur termin *Epir*, “i paemërtuar deri në vitin 500 para e.s.”,¹⁹ sipas termit të përdorur atëkohë dhe dihet se, pas pushtimit ushtarak të Greqisë nga Roma, kulturalisht Roma u pushtua nga grekët. Duke pasur parasysh vendet që rreshton Cezari në veprën e tij, Tesalia, në lindje, në jug të saj Beotia, në perëndim të Beotisë, Akaias, dhe pastaj, në veri të Akaias, Epiri, pa u përmendur prej tij Etolia dhe Akamania, duket sikur këto të fundit, autori i njeh si zona të Epirit të banuar nga epirotët-ilirë. Dhe, po t’i referohemi Tit Livit në librin XXVII, kreu 32, të veprës së tij “Ab urbe condita”, ai thotë “...*Aetolos et Tralles – Illyriorum id est genus - ...*” (...*etolët dhe tralët – d.m.th. farë ilire...*).

Ky term, si u përmend më lart, përdorur në kohët e lashta për të shënuar viset nga Malet e Vetëtimës, zona e Himarës, nga veriu, dhe deri në Gjirin e Artës (Ambrakisë) nga jugu, gjatë Mesjetës bie gjithnjë e më shumë në harresë.²⁰ Por, ndonëse termat “Epir” dhe “epirot”, ranë për shumë kohë në harresë, e sigurt është, se “autorët e mesjetës sa herë që përdorin termat “Epir” dhe “epirotë” për banorët, asnjëherë nuk nënkuptojnë me to Greqinë dhe grekët. Përkundrazi, ata bëjnë një ndarje të prerë mes tyre. Në fillim të shek. XIII, mitropolit i Naupaktit, Apokaukos, pohonte se qyteti i Vonicës në bregun jugor të Gjirit të Artës, shënonte cakun ku fillonte të flitej gjuha greke : në veri, deri thellë në Grebene, sipas Apokaukos, jetonin “barbarofonët”. Pikërisht këtu, në shpatin lindor të vargmaleve të Pindit, që vijnë e treten në ultësirën e Gjirit të Artës, historiani bizantin i shekullit XIII, Georg Akropolit, tregon fillimin e tokës greke. Sipas autorit tjetër të po asaj periudhe, Pahimerit, malet e Pindit ndajnë Epirin nga Greqia e mirëfilltë. “Epiri”, shkruan Ph. Cluverius në shek. XVII, “ndahet prej Maqedonasve nga lumi Kelidon dhe nga malet e Pindit, kurse prej grekëve, nga lumi Akeloos”. Dhe shton: “Banorë të Epirit janë shqiptarët (arbonar) që turqit i quajnë Arnautlerë.” Për t’u shënuar është përputhja e kufijve të Greqisë

klasike, është pak a shumë, tërësia e kantoneve që gjenden në jug të një linje që e shtrijnë nga gjiri i Ambrakisë deri në grykën e Peneut”. Le të kujtojmë me këtë rast edhe fjalët që Polibi na paraqet në veprën e tij “Historiae”, në Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ..., libri XVIII, kreu 5, f. 63, vënë në gojën e Filipit: “Ç’është, pra, kjo Helladë, nga e cila më urdhëroni të dal? Si i caktoni ju kufijtë e saj?”.

¹⁹ N.G.L.Hammond, *Epiri*, Qendra e Studimeve Ndërshtetërore, Tiranë: 2004, f. 153.

²⁰ P. Xhufi, *Dilemat ...*, f. 296.

antike me kufijtë e Greqisë mesjetare. Qysh në kohën e tyre, Tukididi, Efori, Straboni, Skymne, Pseudo-Skylaksi, historianë e gjeografë të tjerë të lashtësisë, kishin treguar: së pari, që kundrejt grekëve, epirotët ishin një popull “barbar”, pra, i huaj, dhe, së dyti, që Greqia fillonte nga ana e Thesalisë në rrjedhën e lumit Peneu, kurse në krah të Epirit, nga bregu jugor i Gjirit të Ambrakisë, nga Akarnania”²¹, që do të thotë se vazhdimisht, që nga lashtësia, vërtetuar prej autorësh edhe grekë, edhe në Mesjetë e deri sot, grekët kufizoheshin bukur qartë me popullsitë ilire, sot shqiptare. Banorët e Epirit ishin epirotët, “të cilët e kanë për gjë të madhe jo vetëm të luftojnë për atdheun e tyre, por edhe të japin jetën për të mbrojtur miqtë e tyre dhe farefisin.”²² Edhe në mjaft materiale të tjera për Epirin lexohet se me mbërritjen e banorëve të rinj (helenët), Epiri .. u nda nga grekët në dy zona të mëdha : Epiri grek dhe Epiri barbar që përfshinte Kaoninë, Thesprotinë dhe Kasiopinë. Kjo zonë ishte kaq e populluar sa Teopompi, i përmendur nga Straboni, numëronte ndërmjet banorëve të saj 14 tribu, të dalluara mes tyre, si: *kaonët, thesprotët, heliopët, molosët, atamanët, perrebejtë*. Në kohët e lashta, tradita historike e përzierë me mitologjinë, na e tregon Epirin nën pushtetin e monarkëve dhe të princëve me origjinë pellazgjike ose aleatë me pellazgët. Më vonë, pas luftës së Trojës, Pirro ose Neoptolemi, i biri i Akilit, në krye të mirmidonëve të Hemonisë, që kishte komanduar i jati dhe që ishin përzënë nga Tesalia prej heraklidëve, erdhën e themeluan ndërmjet molosëve një shtet, që, vit pas viti, u rrit në dëm të popullsisë fqinje. Pasardhësit e tyre të quajtur Eacidë ose Pirridë nuk mundën të ruajnë kufijtë e mbretërisë së tyre dhe nuk mbretëruan më shumë se mbi molosët dhe kaonët. Njëmbëdhjetë popullsitë e tjera të vogla të Epirit, mes të cilëve *thesprotët, atamanët* etj., fituan pavarësinë e tyre dhe u drejtuan nga mbretër vendas. Llogaritet nga Pirroja deri në kohën e luftërave medike, 14 breza mbretërisht të panjohur. Admeti (480 – 429 para e.s.) mbretëronte mbi molosët kur Kserksi pushtoi Greqinë; ai i dha azil Themistokliut, të përzënë e të persekutuar, për të arritur deri te Amynta, që i dha mbesën e tij, Olimpia, Filipit të Maqedonisë, babait të Aleksandrit të Madh. Trualli i Epirit, malor, por pjellor në bregdet, laget nga Akeroni dhe Kokyte dhe ushqen në kullotat e tij të bukura, tufa të

²¹ *Po aty*, f. 309-310.

²² Diodori, “*Bibliotheca historica*”, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ...*, Excerpt. Hoeschel. f. 494-495.

shumta bagëtish; kuajt e tij ishin shumë të vlerësuar dhe të përmendur në lojërat olimpike; qentë e tij të tmerrshëm, të quajtur, mollosë, ishin tepër të kërkuar.²³ Pas Pirros, shteti i Epirit pati shumë kontradikta të brendshme, derisa u dobësua dhe në vitin 232 para e.s., ra. Krijohet, më pas, Lidhja e Epirotëve, që nuk e nxori dot Epirin nga gjendja e krijuar. Në vitin 167 para e.s. Epiri ra nën sundimin romak. Me sistemin e ri administrativ romak, viti 148 para e.s., Epiri u përfshi në Provincën maqedone. Në fund të shekullit II para e.s., Epiri del si provincë më vete.²⁴

Në vendet e larta e të rrezikshme të bregdetit të Epirit zbarkoi trupat e tij Cezari, duke lënë mënjane portet e mëdha e të sigurta të kohës pranë këtyre zonave, si komentohet edhe në një pasazh të kreut të mëposhtëm.

Kreu 6 - ... Ditën tjetër ai preku tokën e Keraunëve. Duke gjetur një liman të qetë mes shkëmbinjsh e vendesh të tjera të rrezikshme të bregdetit dhe duke anashkaluar të gjitha portet, sepse e merrte me mend që ato kontrolloheshin nga kundërshtarët, i zbarkoi të gjithë ushtarët tek ai vend që quhet Palæste, pa humbur as edhe një anije.²⁵

Në 4 janar të vitit 48 para e.s., në zemër të dimrit, pas një plani të paravendosur dhe të mbështetur mbi vëzhgime shumë të hollësishme të terrenit, Cezari niset nga Brindizi; ditën tjetër, me 5 janar, “në mes të

²³ *Grand Dictionnaire Universel du XIX-e siecle* par Pierre Larousse, Tome septieme, zëri Epir, Paris: f. 728. Duke bërë një përmbledhje të gjithë sa u shkrua, në lashtësi, Epiri është dalluar nga Greqia dhe banorët e tij, fiset epirote, njiheshin si popullsi ilire, duke ardhur deri në fillimin e shekullit XX, kur, sa herë është dashur të përmendet nga autorë të ndryshëm, Epiri është quajtur provincë e Shqipërisë dhe banorët e saj, epirotët, janë identifikuar me shqiptarët.

²⁴ S. Islami, “Epiri antik ...”, f. 135, shkruan se në fund të shek. III, me reformën administrativo-ushtarake të Dioklecianit, u krijua *Provincia e Epirit të Ri*, me krahinat midis Vjosës dhe Matit (vise ilire që më parë bënin pjesë në Provincën Maqedone), ndërsa trevat tradicionale të Epirit u quajtën *Provincia e Epirit të Vjetër*. Me interes, vazhdon autori, është të vihet në dukje se të dyja këto provinca bënin pjesë tani në *Prefekturën e Ilirikut*.

²⁵ ... *Postridie terram attigit Cerauniorum (Germiniorum) saxa inter et alia loca periculosa quietam nactus stationem et portus omnes timens, quod teneri ab adversariis arbitrabantur, ad eum locum, qui appellabatur Palaeste, omnibus navibus ad unam incolumnibus milites exposuit. Cesare, De bello ...*, f. 30.

stuhisë”,²⁶ zbarkon në brigjet e Epirit, pranë Palæste-s, sot Palasë, “duke i ikur fshehurazi Mark Bibulit, admiralit të Pompeut, të cilit i ishte ngarkuar ruajtja e detit, dhe kaloi në malet e quajtura Keraune, ku është fundi i Epirit, afër ngushticës së detit Jon.”²⁷ Bibuli, admiral i Pompeut, qëndronte me pjesën më të madhe të flotës, në ujërat e qeta të Korfuzit; porti i Durrësit, në skajin e kundërt, ishte zënë nga anijet rodane dhe liburne, nën komanën e Oktavit dhe të Koponit; kurse pozicioni qendror i Orikumit, fare pranë Italisë dhe Brindizit, ruhej nga 18 anije, që mjaftonin për të mbrojtur limanin, por nuk mund të kryenin ruajtje të frytshme në gjithë këtë pjesë të bregdetit. Cezari, nëse duhet t’i besojmë Dion Kasit, njihnte mirë çdo detaj, prandaj u përpoq shpejt të përfitonte nga përparësia e situatës. Bibuli i kuptoi tepër vonë të metat e masave që kishte marrë, dhe, kur ai i përmirësoi, Cezari ishte tashmë zot i Epirit.²⁸ Zbarkimi në bregdetin e Epirit, që hap përmes një fillimi mahnitës

²⁶ A. Alessandrino, *Delle guerre civili ...*, f. 79.

²⁷ Dionis Casii Cocceiani, “Historia romana”, te *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë ...*, libri XLI, kreu 44, f. 273.

²⁸ Léon Heuzey, *Opérations militaires de Jules César*, Étudiées sur le terrain par la mission de Macedoine, Paris: 1886, f. 19. Në parathënien e veprës së tij, të datës 7 korrik 1886, autori na njofton se këto studime topografike mbi operacionet ushtarake të Jul Cezarit në Epir, në Iliri dhe Tesali, bënë pjesë në punët e kryera, përgjatë vitit 1861, nga Misioni Arkeologjik i Maqedonisë. Ato duhet të shërbenin si dokumente për Historinë e Cezarit, që përgatiste atëkohë Perandori Napoleon III. ... Qëllimi që ne kemi ndjekur, vazhdon autori, është përjashtimisht shkencor. Ne nuk kemi menduar tjetër, veç të ndriçojmë përmes studimit të drejtë të terrenit, faktet ushtarake, të cilat, në vitin 48 para e. s., kanë pasur një peshë kaq të madhe në fatet e botës. Do të shtoj që këto punë nuk janë ndërmarrë nga ne privatisht. Ne, unë dhe zoti M. Daumet, ishim atashuar në shërbim të Shtetit; Ministria e Luftës, na shtoi një nga topografët më të zotë, M. Laloy, ndërkohë që Ministria e Marinës u ndihmoi kërkimeve tona, gjithashtu, me dërgimin e një anijeje të stacionit të Piresë. Të organizuar në këtë mënyrë, misioni ynë nuk mund të mos krijonte një bashkësi dokumentesh me vlerë historike : studime krahasuese me terrenin dhe tekstet, pamje panoramike të vizatuara me imtësi të madhe, ...zbulime të pjesshme, që ndreqin topografinë e lashtë dhe moderne të një vendi të njohur jo mirë; ... të zënë me studimin arkeologjik të një zone të gjerë, ne nuk kemi qenë gjithmonë të detyruar të ndiqnim hap pas hapi marshimet dhe kundërmarsimet e dy ushtrive ndërluftuese. Para së gjithash, ne e kemi përqendruar vëmendjen tonë në tri pika, që i përgjigjen tre fakteve të rëndësishme të fushatës: zbarkimit në Epir, bllokimit të Dyrrahut, betejës së Farsalës. ..

fushatën e Farsalës, është, ndoshta, veprimi më i guximshëm i gjithë jetës ushtarake të Jul Cezarit.²⁹

Palæste (sot, Palasë) nuk është e përmendur nga autorë të tjerë para Cezarit, sepse nuk kishte asnjë lloj rëndësie përgjatë gjithë vijës bregdetare të atyre viseve, mbushur me limane e porte gjithfarësh, sipas nevojave të periudhës. Duke njohur stilin e tij shumë të ngjeshur e të shpejtë, jemi të bindur se Cezari e përmend Palæste-n (Palasën), sepse kjo pikë epirote dhe ky çast qenë nga më të rëndësishmit për të dhe për historinë e mëtejshme të Romës, si shihet më vonë, sepse shënuan fillimin e asgjësimit të Pompeut dhe zanafillën e fuqisë dhe të pushtetit të tij. Palæste është përmendur edhe nga Lukani, por pas Cezarit, kur shkroi poemën “Pharsalia”. “...Por kur nata iku / reja mori shkëlqimin e ditës, detin pak nga pak / e tundi deri në thellësi dhe ua lëvizi Keraunet lundërtarëve./ Prandaj anijet filluan të rrëmbehen dhe ujërat e shqetësuar flotën /shpejtuan; që tashmë nga era dhe vala e mbarë / rrëshkiti, e çengelat në rërën e Palæste-s hodhi.³⁰ Palæste (Palasë), pika epirote ku gjenerali romak zbarkoi atë pjesë të ushtrisë së tij, të cilën mundi ta hypte nëpër anije, ka hyrë në histori, pikërisht për këtë arsye, nga zbarkimi i Cezarit në këtë pikë të papërdorshme për këtë qëllim nga asnjë tjetër para e pas tij. Dhe nuk e ka përmendur më kush Palæste-n³¹, veç atyre që janë

²⁹ *Po aty*, f. 3.

³⁰ M. Annaeus Lucanus, *De bello civili seu Pharsalia*, libri V, vargjet 455 – 460 (... *sed nocte fugata / laesum nube dies jubar extulit imaque sensim / concussit pelagi movitque Ceraunia nautis. / inde rapti coepere rates atque aequora classem / curua sequi, quae iam vento fluctuque secundo / lapsa Palaestias uncis confixit harenas*/. Lukani, nipi i filozofit Seneka, lindi në Kordovë më 3 nëntor të vitit 39 të e.s.. Për formimin që pati, Neroni e ftoi në rrethin e miqve të tij, por kjo miqësi u kthye në armiçësi, sepse Lukani mori pjesë në komplotin kundër Neronit dhe ky e dënoi me vdekje; vdiq në 30 prill të vitit 65 të e.s. Vepra kryesore e tij *Pharsalia*, e ruajtur, por e papërfunduar nga vdekja tragjike, ndahet në 10 libra. Gjatë përshkrimit të luftës civile, Lukani jep edhe zakone e karakteristika të popullsisë vendase.

³¹ Edhe Teodor Mommsen në veprën e tij *Storia di Roma antica*, vëllimi III, libri V, kreu X, § 14, Casa editrice nazionale Roux e Viarengo, Roma-Torino: 1903, f. 345, bën paraqitjen e këtij çasti, shumë të rëndësishëm për vazhdimin e mëtejshëm të veprimeve të Cezarit: “Cezari u hipi anijeve në Brindizi drejt bregut të Epirit më 4 janar, në krye të gjashtë legjioneve, me radhë të rralluara nga mundimet dhe sëmundjet, dhe të gjashtëqind kalorësve. Ishte ky një organizim i dytë i ekspeditës së pamenduar të bërë në Bretanjë; por qe me fat, të paktën në turrin e

marrë apo kanë shkruar për luftën civile mes Cezarit e Pompeut, por, si duket, mbështetur në vetë përmendjen e Cezarit, këmba e të cilit e preku atë tokë. Shumë shekuj pas ngjarjeve të treguara nga Cezari, koloneli anglez Martin Lik, me detyrën e konsullit pranë Ali Pashë Tepelenës në Janinë, në dhjetor të vitit 1804, shkruante : “Pasdreke lundruam në këmbët e majës së malit të Akrokerauneve, në shpatin e të cilit gjendet fshati Palasë, një emër që të kujton vendin ku Cezari zbarkoi, nisur nga Brindizi, në fushatën e tij kundër Pompeut në Iliri.” Duke qenë ushtarak, Lik u përpoq të vendoste në terren përshkrimet e kësaj fushate, që vendosi fatin e ardhshëm të Romës, duke u mbështetur në shënimet e Cezarit, si dhe në historinë e Romës, të shkruar nga Apiani në shekullin II pas e.s..³² Sipas studiuesve, Palæste (Palasë) është realisht, nga të gjitha vendet e banuara të zonës së Himarës, më e larguara nga Korfuzi, ku ndodhej trupa e madhe e anijeve pompejane, dhe, më e afërta, në të njëjtën kohë, nga kalimi i vetëm që të çon, përmes maleve, kah gjiri i Orikumit.³³ Vendzërkimi i Cezarit, pra Palæste, nuk është vënë kurrë në dyshim nga studiuesit e tij, sepse ky vend plotësonte kushtet që ishin të domosdoshme për të : ishte mol i vogël peshkimi apo strehimi, i humbur mes gropësirave të maleve, mbasi i duhej të shmangte “të gjitha portet”; kishte një hapësirë ranishteje të mjaftueshme, ku mund të afroheshin njëherazi një numër i madh mjetesh lundrimi dhe u lejonte trupave të grumbulloheshin pa pengesë. Në këtë zonë, nga jugu, ndodhej porti i vogël Palermo, strehë e madhe dhe e sigurt, i njohur mirë që në lashtësi, me emrin Panormos; ky ishte strehimi i zakonshëm i anijeve të mëdha të zonës në stinën e dimrit. Cezari e kishte shmangur këtë port, ashtu si gjithë portet e tjerë, duke besuar se atje mund të haste në ndonjë patrullë detare pompejane. Përkundrazi, plazhet e afërta i ofronin atij pozicionin më të volitshëm që ai mund të dëshironte për të hedhur trupat e tij në

parë. Grupi bregëzoi në stere në mes të shkëmbinjve Akrokeraunë (shkëmbinjve të Himarës), në radën e shkretët të Palasës. Transporti i parë i Cezarit bregëzoi pa kurrfarë pengese, ndonëse flota armike ishte aty afër, në Orikum e në Korçirë. Ndërsa anijet ktheheshin mbrapsht pa pengesë për të bërë një transport të dytë, po atë natë, Cezari kapërceu malet Akrokeraune. Sukseset e tij të para qenë kaq të mëdha, e po kaq i madh qe befasimi i armikut..”.

³² Neritan Ceka, *Udhëtim në këshjtjellat ilire*, Tiranë: “Migjeni”, 2005, f. 165.

³³ L. Heuzey, *Opérations militaires ...*, f. 13.

bregdet.³⁴ Për gjiun Palermo (në lashtësi: Panormos) ka shkruar, si e ka prekur vetë, edhe Pukëvili, që ka bërë këtë përshkrim, duke na treguar se gjiu ose porti i Palermos është në një hark prej pesë miljesh, me një dalje rreth një çerek milje midis pikave shkëmbore, ku deti përplasat furishëm. Ai ka një pozicion të mirë dhe është i siguar ndaj çdo sulmi të jashtëm. Nga të gjitha anët rrethohet nga male të lartë, gjë që e bënte rrallë objekt të erërave të forta. Pra, si përfundim, gjiu apo porti i Palermos në kohë të lashta, madje edhe tani, mund të jetë quajtur Panormos, sepse në çdonjërin anë të tij, anijet mund të qëndronin mjaft mirë të siguruar kundruall detit.³⁵ Duke qenë vend i kërkuar dhe i përdorur nga anijet, Cezari me ushtrinë e tij, nuk mund të mos binte në sy në atë port. Dhe ai kishte zgjedhur për këto arsye, pikërisht, Palæste-n, për të zbarkuar.³⁶ Kjo

³⁴ *Po aty*, f. 21. Banorët e Palasës përmendin ende sot mallkimin kundër një tradhtari që i kallëzoi armikut shtigjet e malit. “Disa të huaj, thonë ata, kishin zbarkuar në breg; një banor i fshatit i këshilloi të zbatnin këpucët e tyre të rënda dhe të merrnin sandale prej lëkure keci, nga ato që përdornin barinjët e zonës, dhe vetëm kështu ata mundën të ngjiten shpatet e ashpra dhe të arrinin në majë”. Kur i pyet për kohën e kësaj historie të çuditshme, ata të përgjigjen se, “në atë kohë luftohej ende me shigjeta”. Këto detaje përkujtojnë, ndoshta, me ndonjë ngjarje krejtësisht lokale, më shumë sesa me ngjarjen që na shqetëson ne: por këto na japin sot një ide të ashpërsisë së maleve dhe të vështirësive që kishin pasur përpara ushtarët e Cezarit pas zbarkimit të tyre, na rrëfen Hëze mbi këtë ngjarje.

³⁵ Pukëvil, *Në oborrin e vezirit të Janinës* (Shënime udhëtimi, shkruar 200 vjet më parë), kreu III, “Udhëtim përgjatë bregdetit shqiptar dhe Epirit, nga Raguza deri në Porto Palermo”, Tiranë: “Horizont”, 1999, f. 68.

³⁶ Studiuesi N.G.L.Hammond, duke komentuar këtë zonë në veprën *Epiri ...*, f. 19, shkruan se pjesa më e rrezikshme e lundrimit ishte nga Korfuzi për në gjirin e Vlorës. Shkëmbinjtë e kontinentit bien pingul mbi det dhe bregu është në pritje të rrezikzive që rreken t’u shpëtojnë stuhive. Bregu ngrihet përpjetë, në mbi 6 000 këmbë lartësi, nga Keraunet ose Malet e Vetëtimave, të njohura si mbarështueset e stuhive. Deti bëhej më i rrezikshëm skaj vargmalit të Kerauneve, në kepin e Karaburunit ose të Gjuhëzës. Kryqtarët të udhëhequr nga Rikard Zemër Luani, pësuan humbje të rënda gjatë kalimit nga Italia në Epir, pikërisht në kepin e Gjuhëzës. Jul Cezari ishte më me fat. Duke i besuar yllit të vet të fatit, ai nisi lundrimin nga Brindizi në Epir me shpresë që të zbarkonte midis dy ushtrive të Pompeut që ishin bigëzuar në Korfuz dhe Orikum, te Gjiri i Vlorës. Era e veriut e shpuri flotën e tij me shtatë legjionet shëndosh e mirë dhe në fshehtësi të plotë në Palestë, Palasën e sotme, në bregdetin e tmerrshëm të Kerauneve. Prej këtej ndërmori një marshim të vështirë përmbi malet..Kjo ishte lëvizja e parë e shkëlqyer e Jul Cezarit.

zonë me shkëmbinj të thyer dhe vende të rrezikshme, pika më e lartë e zbarkimit, ndodhet në të kundërt të terrenit ku do të zhvillohen luftimet përfundimtare mes dy ushtrive romake. Vetë përshkrimi që i ka bërë Cezari vendit të ndalesës dhe zbarkimit të forcave të tij, na bën të kuptojmë se aty kishte një shteg të vetëm, të përshtatshëm për lëvizjen e trupave që, nga Palæste (Palasë), i udhëhoqi nëpër qafën e Llogarasë drejt gjirit të Vlorës. Studiuesi Hëze (Léon Heuzey) thotë se kjo pikë duhej të ishte detyrimisht në lidhje me ndonjë rrugë që kalonte përmes maleve. Vetëm me këto kushte Cezari mund të shpëtonte nga rreziku i dyfishtë, mes të cilit ishte hedhur : të parandalonte sulmin e flotës armike dhe të zinte në befasi legjionet e pjesës së brendshme.³⁷ Nga të gjitha vendet e banuara të Himarës, Palæste (Palasë) është pika më e largët nga Korfuzi, ku Pompeu kishte flotën, dhe më e afërta, në të njëjtën kohë, me shtegun e vetëm që të çonte përmes maleve drejt gjirit të Orikumit. Ja si e përshkruan Hëze: “Në njëfarë largësie nga fshati, shihet një prroskë e gjerë që zbret nga maja ... dhe shënon në faqe të malit një vrragë të bardhë shumë të madhe; kjo prroskë që duket larg nga deti, njihet mirë nga të gjithë lundërtarët e Adriatikut; kjo është për ta si një sinjal i largët në gjatësinë e këtij këndi të egër. Ata e quajnë Rruga e Bardhë ... Këmbëngul me dashje në këtë fakt, në dukje pa rëndësi, për të treguar se si marinarët e brigjeve të Italisë njihnin në detaje të gjitha këto vende të largëta. Pra, është mbi këto njoftime të sakta që Cezari zbarkoi në ranishten e Palasës dhe hasi në pikën e vetme të prekshme në të gjithë këto ledhe malesh.³⁸ Edhe Pukëvili shkruan : “Shumë shpejt u ndodhëm përballë një përroi të gjerë që ridhte nga malet, i quajtur nga marinarët italianë Strada Bianca, përkthyer nga emërtimi epirot *Aspri rouga*, rruga e bardhë”.³⁹ Ishte një shteg i vështirë dhe malor, i mundur për t’u kaluar vetëm në kolonë të thjeshtë. Cezari nuk jep shpjegime të tjera, përveç

³⁷ L. Heuzey, *Opérations militaires ...*, f. 11.

³⁸ *Po aty* f. 13. “Diku, mes këtyre vargmaleve të rrëpirët, në një luginë të vogël, thotë Hëze, gjen gjurmë ndërtimesh antike dhe një numër të konsiderueshëm mbeturinash poçerie. Banorët pretendojnë se është vendndodhja e lashtë e Palasës, që, atëherë, ishte një fshat i madh, popullsia e shpërndarë e të cilit ka formuar fshatrat e sotëm përreth. Sipas Hëze-s, kjo zonë shënon me siguri pozicionin antik të Palasës, që ndodhej në breg të detit dhe krejt pranë ranishteve ku shkelën ushtarët e Cezarit gjatë zbarkimit”.

³⁹ Pukëvil, *Në oborrin e Vezirit ...*, kreu III, “Udhëtim përgjatë bregdetit shqiptar dhe Epirit, nga Ragusa deri në Porto Palermo”, f. 65.

ngutjes me të cilën ai vazhdon marshimin. Edhe burime të tjera e paraqesin këtë çast të vështirë, por të mirëstudiuar të Cezarit, i cili, pas kësaj, “nisi anijet për Brindisi që të merrte pjesën tjetër të ushtrisë, kurse vetë u nis natën për Orikum, duke qenë i detyruar të ndante trupat në njësi të vogla nga rruga e ngushtë dhe shkëmbore, kështu, nëse dikush e diktonte mbërritjen e tij, mund të sulmohej me lehtësi”.⁴⁰ Përbri shtegut që kalon nëpër qafën e Llogarasë dhe që përputhet në çdo veçanti me përshkrimin e bërë nga shkrimtari grek, Apiani, çdo përparim i kolonave të tjera, e për më tepër natën, është i pamundur. Nga njoftimi i Apianit mund të kuptojmë vetëm shkëputjen e pavullnetshme të kolonës së shpeshtë gjatë marshimit, gjë e pashmangshme edhe për trupat më të mirë përgjatë marshimeve natësore. Kjo gjë përforcohet më shumë kur Apiani na thotë për rrezikun në të cilin ndodheshin këta trupa në njësh kolonë, po të sulmoheshin nga forca armike. Ishte e pamundur, pra, të ecej në disa kolona nëpër shtegun e ngushtë të maleve karstike.⁴¹ Edhe shkrimtari latin Luk An Flori ka paraqitur më gjatë se vetë Cezari, por gjithsesi mjaft shkurt, këtë zbarkim të Cezarit. “Pompeu kishte zgjedhur Epirin për luftë. Edhe Cezari nuk vonohet. Vuri rregull tek ata që la mbrapa dhe, duke kaluar pengesat e shkaktuara nga ashpërsia e dimrit, lundroi nëpër shtrengatë drejt luftës; kampin e vendosi pranë Orikumit”...⁴² U desh shumë kohë të përshkohej shtegu i ngushtë përmes shkëmbinjve, deri në zbritje, i 15 mijë trupave, i kuajve e materialeve të tjera të nevojshme dhe disa orë të tjera deri në Orikum. Kreu i kolonës në marshim mbërriti në agim pranë Orikumit, kurse grumbullimi i tërë ushtrisë, sigurisht, ka kërkuar edhe disa orë të tjera. Vetë Hëze me grupin e tij të vogël është përpjekur të përshkojë rrugën që kanë bërë 2 000 vjet më parë trupat e Cezarit. “Neve na u deshën dhjetë orë të marshonim ngadalë pas bagazheve tona, të vëna në shpinë të mushkave, për të kapur vendin ku akoma sot shihen gjurmët e Orikumit të vjetër. Të zënë nga nata, ne nuk

⁴⁰A. Alessandrino, *Delle guerre civili ...*, f. 79.

⁴¹ Giorgio Veith, *La campagna di Durazzo tra Cesare e Pompeo*, Roma: 1942, f. 66.

⁴² L. Annaei Flori, *Epitome*, liber secundum, XIII. *Bellum civile Caesaris et Pompei* (..bello Pompeius Epiron elegerat; nec Caesar morabatur. Quippe ordinatis a tergo omnibus, quamvis hiems media prohiberet tempestate, ad bellum navigavit; positisque ad Oricum castris, ..).

do të mund të kishim bërë asnjë hap pa drejtuesin tonë, një shqiptar i malësisë, njëherësh bari dhe ushtar, i cili njihnte gjithë gurët e rrugës”.⁴³

Një emër tjetër që lexojmë në këtë kaptinë nga vepra e Cezarit është *Cerauniorum* (në gjinore shumës). Komentatorët e ndryshëm të veprës së Cezarit shprehen nëpër shënimet e tyre se emri *Cerauniorum* është një hamendje e vjetër, e përdorur në vend të *Germiniorum* që gjendet në kodikë. Në botimet më të reja të kësaj vepre emri *Germiniorum* është zëvendësuar me *Cerauniorum*, duke menduar se kemi të bëjmë me një lajthitje të kopistit dhe se emri i fisit kaon, për të cilin bëhet fjalë, duhet të ketë qenë si i malit Ceraunia (Malet e Vetëtimës), rrëzë të cilit shtrihet trualli i tij. Hëze, që është i pari historian e arkeolog që shkeli në vendin e zbarkimit afër fshatit Palasë, u shfaq kundër këtij zëvendësimi, duke paraqitur si argument të fortë se emrin *Germiniorum* na e kujton edhe sot emri i fshatit të afërt Dhërmi. Malet e larta që i rrethojnë nga veriu dhe lindja, bënë që kjo nyjë e ngushtë bregdeti të mbetej e paprekur nga dyndjet e shumta që vërshuan mbi vendin tonë, duke na ruajtur më shumë e më pastër se në çdo krahinë tjetër, emrat e lashtë të kumtuar nga burimet antike.⁴⁴ Cezari zbret në Paleste (Palasa e Himarës) në tokën e Germinëve (Dhërmi i sotëm), prandaj “unë nuk shoh asnjë arsye që *Germinii* i dorëshkrimeve më të lashta të zëvendësohet me Ceraunii. Edhe nga pikëpamja gjuhësore nuk më duket të ketë ndonjë pengesë për prejardhjen e Dhërmi nga Germin; në Elbasan e Peqin në disa fjalë nuk bëhet dallim ndërmjet g-ësë dhe dh-ësë: ghashë=dhashë”.⁴⁵ Dhe kjo duket e drejtë, derisa një nga kriteret e të caktuarit si gjuhë indoevropiane e tipit kemtum apo satem është “trajtimi i guturaleve palatale (k, g). Gjuha shqipe këto palatale i paraqet të ndryshuara në spirante interdentalë, pra, -g- në -dh-”.⁴⁶ Këtë mendim e përkrah edhe gjuhëtari Seit Mansaku, i cili thotë se, në sajë të studimeve të një vargu dijetarësh që janë marrë me historinë e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe me toponiminë historike në veçanti, e sidomos, në sajë të sintezës që u ka bërë këtyre studimeve prof.Çabej, kanë hyrë tashmë në fondin e qëndrueshëm të dijes gjuhësore barazimet bashkë me shpjegimet

⁴³ L. Heuzey, *Opérations militaires ...*, f. 21.

⁴⁴ Hasan Ceka, *Në kërkim të historisë ilire*, Akademia e Shkencave, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 1998, f. 193.

⁴⁵ Hasan Ceka, “Diskutim rreth kumtesës së Çabejt”, në *Konferenca e parë e studimeve albanologjike*, Nëntor 1962, Tiranë: 1965, f. 344.

⁴⁶ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëllimi III, Prishtinë: 1976, f. 14.

përkatëse të emrave të lashtë: Aulonë:Vlorë, Arachton:Artë, Durrachium: Durrës, Candavia:Kunavja, Lissus:Lesh, Piruste:Qafa e Prushit, Scampinus: Shkumbin, Scodra:Shkodër, Thyamis:Çam, Ulcinium:Ulqin etj., Mund të futet këtu edhe *Germinium:Dhërmi*, që përmend Cezari në formën e gjinore së shumësit *Germiniorum*, që me sa duket, siç ka vërejtur arkeologu H. Ceka, është përdorur në fillim si emër fisi, pastaj si emër vendi. Kalimi *Germinium:Dhërmi* mund të shpjegohet në shqipe me shndërrim të grykores -g- në ndërdhëmboren -dh-, megjithëse ky është një fenomen i hershëm.⁴⁷

Malet Akrokeraune (Malet e Vetëtimës) ishin mjaft të njohura edhe në lashtësi, sepse ishin të lartë dhe në to binin shumë rrufe. Duke e menduar të pamundur zbarkimin në këtë pikë të bregdetit, edhe admirali pompejan, që ishte fare afër, nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur, duke i lejuar Cezarit, “*qui vidit mare turgidum et / infames scopulos Acroceraunia* (i cili pa detin e stuhishëm dhe /shkëmbinjte e frikshëm Akrokeraunë”⁴⁸) të zbarkonte pa rrezik, pikërisht këtu. Përmendjen e këtyre maleve e gjejmë shumë herët, si tek Skylaksi, që në shek. VI para e.s.: “në këto vise janë malet Keraune (në Epir) dhe aty afër është një ishull i vogël që quhet Sason”; ose “Gryka e gjirit Jon shkon që nga malet Keraune, gjer te kepi i Japygisë. Prej maleve Keraune, gjer në qytetin Hydrunt (sot: Otranto) të Japygisë, lundrimi është pesëqind stade”.⁴⁹ E gjejmë te Scymni Chii, i cili na tregon për malet Keraune: “Brentesi (sot: Brindizi), liman i mesapëve, / kurse përkundrejt tyre janë malet Keraune”.⁵⁰ Akrokeraunet janë quajtur kështu që në lashtësi, për arsye të lartësisë dhe veçanërisht për shkak të ekspozimit të tyre ndaj detit, të ndriçuar shpesh me dritën e vetëtimave. Keraune është vendi, i cili, sipas disa studiuesve, përmendet nga Circea në udhëzimet e saj drejtuar

⁴⁷ Seit Mansaku, “Në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë”, *Studime filologjike*, 3-4, Tiranë: 1982, f. 106.

⁴⁸ Q. Orazio Flacco, *Carmina*, libri I, kënga III, Società An. G.B.Paravia&C., Torino: 1938, f. 23.

⁴⁹ Scylacis Cariandensis, “Periplus”, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ...*, kreu 27, f. 36.

⁵⁰ Scymni Chii, “Orbis descriptio”, në *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë ...*, vargu 363-364, f. 72. Skymni, gjeograf grek që jetoi në shekullin III-II para e.s. Mendohet se, pa të drejtë, këtij autori i atribuojnë veprën e përmendur. Gjithsesi, në këtë vepër gjejmë të dhëna për gjeografinë dhe historinë e Ilirisë dhe të fiseve epirote.

Uliksit.⁵¹ Edhe Apollodori na tregon për ndonjë ndodhi në këto male: “Përsa u përket kolhëve që ishin dërguar për të ndjekur anijen (e argonautëve) dhe që nuk kishin mundur ta arrinin, disa u vendosën në malet Keraune”.⁵² Historiani grek, Straboni, nga ana e tij, na ka lënë shënimin se në këto zona mund të jenë endur argonautët, duke na thënë se, ndoshta, Jasoni ka qenë endur nëpër Itali. Të paktën në malet Keraune, në brigjet e Adrias, në gjirin e poseidonasve dhe në ishujt pranë Tyrrenit duken disa shenja, që flasin për endjen nëpër këto anë të argonautëve.⁵³ Piktura të vjetra janë gjetur të skalitura në gurët e mureve të një gurorjeje të shek. III para e.s. në gadishullin e Akrokeraunit, “të njohura si mbarështueset e stuhive”.⁵⁴ Gjiri i Shkronjave ishte e vetmja strehë për detarët. Gjiri quhej kështu nga mbishkrimet. Këto gdhendje nëpër shkëmbinj ishin lutjet e bëra nga grekët, romakët dhe lundërtarët e mesjetës në adhurim të Dioskurit, Kastorit, Poluksit dhe mbrojtësve të tjerë, qoftë hyjni, qoftë shenjtorë.⁵⁵ Në murin shkëmbor të gurores së mermerit janë skalitur dy fytyra njerëzish, ndoshta dy skllevër që punonin aty në atë kohë. Gurorja tjetër e quajtur Gramata, është e mbushur plot me qindra mbishkrime, simbole e figura, të cilat shpjegojnë kulturën e dy mijë vjetëve të shkuara. Malet e zhveshur, që ndërthuren me gjiret e mrekullueshëm dhe greminat e humnerat e paimagjinueshme, konsiderohen nga vendasit si faktorë kryesorë, mbrojtës ndaj çdo armiku.⁵⁶

Nëpër shtegun e ngushtë të shpateve të ashpra dhe të rrëpirëta të këtyre vargmaleve marshuan ushtarët cezarianë. Në fillim, ushtarët duhet të jenë ngjitur pa vështirësi shpateve të maleve, deri në lartësinë e fshatit të sotëm të Palasës. Këtu, ata hasën një bigëzim të rrugës, që i detyroi të ndahen. Dy shtigje të futnin në grykat me dredha të Rrugës së Bardhë : njëra, më e shkurtër, e mundshme vetëm për njerëz më këmbë, kapërcën menjëherë përroin dhe vizaton dredha të vështira në shpatin konkav të malit Fageo; tjetra, që ndjekin, dhe i bien rrotull bashkë me kafshët e

⁵¹ Pukëvil, *Udhëtim në oborrin e Vezirit ...*, kreu IV, f. 71.

⁵² Apollodori, “Bibliotheca”, te “*Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ...*”, libri I, f. 75.

⁵³ Strabonis, “Geographica”, te “*Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë ...*”, libri I, kreu 2, f. 150.

⁵⁴ N.G.L.Hammond, *Epiri ...*, f. 19.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ Pukëvil, *Udhëtim në oborrin e Vezirit ...*, kreu IV, “Akrokeraunet ose rajoni Malor i Himarës”, f. 73.

barrës, gjarpëron përgjatë bregut të majtë të proskës, kthehet bashkë me të deri në fund të honeve Dikoroe, të krijuara në këmbë të malit të Çikës, dhe, pasi kapërcen një degë të përroit të quajtur Vurlia, vjen e bashkohet me degëzimin e parë, te qafa e Diaporit.⁵⁷ Hëze mendon se “nëpër bigëzimin e fundit duhet të ketë ecur kalorësia, e ndjekur nga materiali që Cezari kishte marrë me vete. Këmbësoria kishte përparësi, për të fituar kohë, të ndiqte njëherësh të dyja shtigjet. Nevoja për t’u rreshtuar për një, shkaktoi vonesë të konsiderueshme”; kështu duhet të ketë ndodhur që, ndërsa një e katërta e forcave priste për t’u nisur për rrugë, kohortat e para kishin kapërcyer grykat më të larta të maleve.⁵⁸ Duke ndjekur përsëri mendimin e Hëzes, që i ka shkelur vetë këto vende, pas këtyre qafave e grykave malesh, fillon zbritja. Futesh fillimisht në një përrua të gjerë, në dy brigjet e të cilit shtrihet një pyll me drurë të rrallë; janë pisha të mëdha që lartësohen përmes tufave të busheve. Ky detal i fundit nuk duhet neglizhuar, sepse bushi ishte, në lashtësi, një nga prodhimet me emër të Orikumit.⁵⁹ Madje, një dëshmi e qartë e pozicionit të Orikumit vazhdon të jetë ende druri i bushit, të cilit i thurin shumë lavde autorët antikë.⁶⁰ Në këtë pjesë të rrugës, një numër i mjaftë kalimesh përmes busheve u lejonte ushtarëve të Cezarit të përparonin në numër më të madh dhe me hap më të shpejtë. Këtu filloi ajo shpërndarje e ushtarëve që mund të ishte kthyer në të kobshme, nëse ushtria nuk do të ishte e mbrojtur nga vetmia e këtyre vendeve dhe nga errësira. Merret me mend që pararoja, e drejtuar nga udhërrëfyesit e Palasës, del nga këto bushe përpara natës : kah mbrëmja, ajo mundi të shihte së largu nga lartësitë e Llogarasë, detin dhe portet e Orikumit.⁶¹ Këtu, pranë Qafës së Llogarasë, kemi emërtimin *Qafa e Cezarit*; pas të gjitha gjasave, kjo duhet të ketë mbetur që nga viti 48 para e.s., kur kaloi nëpër të ushtria e Cezarit që vinte nga Palasa, ku kishte zbarkuar për t’u ndeshur me ushtritë e Pompeut që ishin përqëndruar në Iliri. I këtij mendimi është arkeologu Ceka.⁶² Pasi kalohen këto vende gjatë zbritjes, ku hasen edhe ujëra të shumta, hapet një fushë e vogël, e lagur nga veriu prej ujërave të gjirit të Aulonës. Sipas

⁵⁷ L. Heuzey, *Operations militaires ...*, f. 21.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ Pukëvil, *Udhëtim në oborrin e Vezirit ...*, kreu IV, f. 75.

⁶¹ L. Heuzey, *Opérations militaires ...*, Paris: 1886, f. 22.

⁶² N. Ceka, *Udhëtim në kështjellat ...*, f. 145.

Hëzes, këtu duhet të ketë qëndruar ushtria gjatë natës dhe të ketë ndrequr kolonat, duke pritur çastin për të marshuar për Orikum.

Vijon në numrin tjetër.

S u m m a r y

EPIRUS IN THE WORK OF JULIUS CESAR, “ON THE CIVIL WAR”

As Cesar and Pompey could not sort out their contradictions through mediations, they turned to arms. The struggle between the two, took place in the Illyrian territories which became the battlefield between the two most powerful people of Rome of the 1st century BC., more specifically in 48 BC. Initially it was Pompey who came to Illyricum and after him Cesar, who took note of all the events that took place there, making thus the third book of his works to have a special importance for the Albanian studies. The lack of works from native authors increases the importance of Cesar's writings, who in his limited lines gives valuable information on the ancient history of Epirus. In several of its 112 chapters, the third book gives data on Epirus and some of its towns. The aim of this article is to highlight the information obtained from this work, which has been enriched with other sources of earlier and later authors. We consider that these data are of a great importance for the Illyrian studies, as a part of the Albanian studies, in order to better understand and highlight the ancient history of the territories where our ancestors once lived. Names of places and areas such as: Epirus, *Palæste* (today Palasa) in Himara, are remembered in history for the importance they had for the roman general during his landing and are not mentioned by any other contemporary apart from Lukan.

Likewise, the name *Cerauniorum* (*terra Cerauniorum – in plural*) which in earlier publications was named *terra Germiniorum* meaning the territory of Germins, testifies for the presence of an ancient tribe among the large tribe of Kaons, where *Palæste*, Palasa of Himara was situated, and also giving a more clear and precise account of the Illyrian tribes and the continuity of Illyrian names inherited by the present day Albanians. This first part of the article is also complemented by other earlier, contemporary and later authors and sources such as Tuqiditis, Strabonis, Skylaks, Diodor, Apiani, Dion Kas, Apollodor, Skymni, Tit Liv, Lukan, Plin, Flori, Horacio, Ange Masci, Mommsen, Hahn, Pukvill, Hezei, Hammond, Çabej, H.Ceka etc.

